
RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**Mbrojtje lagjja Bejdollare, lumi Osum,
Berat**

**ZHVILLUES: Drejtoria e Ujitjes dhe
Kullimit Korce**

**PROJEKTUES: “HYDRO-ENG
CONSULTING” Sh.P.K**

Adresa: Berat (Lagjja Bejdollare)

2025

Permbajtja

Hyrje	4
1. INFORMACION PERQELLIMIN E VNM-SE DHE METODIKEN E ZBATUAR	5
1.1 Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se.....	6
1.2 Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional	7
1.3 Kuadri Ligjor Kombetar.....	9
2. PERSHKRIMI PROJEKTIT	9
2.1 Perhkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar edhe me fotografi 17	
2.2 Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij	37
2.3 Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer	38
2.4 Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si: ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe per prodhimin e mbetjeve	42
2.5 Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuar	46
2.6 Te dhena per shtrirjen e mundshme hapsnore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te	46
2.7 Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitim	49
2.8 Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis	51
2.9 Ndikimet e mundshme ne mjedisin nerkuftar (nese projekti ka te tilla).....	58

Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti (pika 1.1.j e raportit paraprak VNM)

Shoqëria :“HYDRO–ENG CONSULTING” sh.p.k me NIPT: M11417503F ka kryer projektimin e objektit “Mbrojtje lagjja Bejdollare, lumi Osum, Berat”.

Adresa: Bashkia Berat, ne kete siperfaqe do te zhvillohen punimet per mbrojtjen lumore ne lagjen Bejdollare, lumi Osum. Per kete do te pergatitet nje raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis te ketij projekti per pajisjen me vone me gjithe dokumentacionin e nevojshem.

Objektivi i projektit është mbrojtja e Lagjes Bejdollar në Berat nga përmytjet dhe erozioni i shkaktuar nga Lumi Osum, nëpërmjet realizimit të veprave mbrojtëse dhe stabilizimit të brigjeve të lumit

VNM eshte hartuar sipas VKM Nr. 686, date, 29.07.2015, “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”, dhe sipas Ligjit Nr. 10 440, date, 07.07.2011, “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, projekti ne fjale **klasifikohet ne Shtojcen II, pika 11. Projekte te tjera c) Mbrojtje lumore (Projekte qe nuk perfshihen ne shtojcen 1)**

❖ HYRJE

Ky Vlerësim Paraprak i Ndikimit në Mjedis (VNM) është përgatitur për projektin “Mbrojtje e Lagjes Bejdollar nga Lumi Osum” në Berat dhe përbën pjesë të dokumentacionit teknik dhe mjedisor të nevojshëm për pajisjen me lejet dhe miratimet përkatëse nga institucionet përgjegjëse.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacionit mbi kushtet aktuale të zonës ku do të realizohet ndërhyrja, duke përfshirë karakteristikat fizike, hidrologjike, gjeologjike, biologjike dhe socio-ekonomike të territorit. Në procesin e hartimit të VNM-së janë përdorur të dhëna ekzistuese, studime teknike dhe informacione të përfituara gjatë inspektimeve në terren, të cilat janë analizuar në përputhje me standardet dhe normat mjedisore në fuqi për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale që mund të shkaktohen gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të veprës së mbrojtjes lumore.

Ky raport hartohet në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe shërben si dokument mbështetës për institucionet vendimmarrëse në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektit. VNM-ja përbën një proces sistematik për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e efekteve që aktiviteti i propozuar mund të ketë mbi mjedisin natyror dhe atë urban, duke marrë në konsideratë jo vetëm aspektet mjedisore, por edhe ato sociale, ekonomike dhe të sigurisë publike.

Në hartimin e këtij raporti janë marrë në konsideratë parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrjes së masave paraprake;
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimi i minimizimit dhe kompensimit të ndikimeve negative;
- Parimi i qasjes së integruar;
- Parimi i përgjegjësisë dhe bashkëpunimit ndërinstitutional;
- Parimi “Ndotësi paguan”;
- Parimi i informimit dhe pjesëmarrjes së publikut;
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit.

Vendi i ndertimit te mbrojtjes lumore eshte i vendosur ne vendodhjen e meposhtme dhe me kordinatat respective sipas sistemeve perkatese:



Figura Nr. 1 Vendndodhja e objektit

Tabela Nr. 1 Tabela e koordinatave të pikave të poligonit të fiksuar në terren

Nr.	Y	X	Z
BM1	409183.383	4510073.813	74.33
BM2	408898.382	4510129.746	75.105
BM3	408882.04	4510360.378	72.65
BM4	409176.873	4510221.563	74.95

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikojë, identifikojë, vleresoj dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin ne mjedis te projektit te propozuar.

Procedura e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis perfshin:

1. Procesin paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis;
2. Procesin e thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis;

Dokumenti baze ku mbeshtetet procesi VNM-se per projektet Paraprake eshte Shtojca II kurse per projektet e Thelluara Shtojca I te Ligjit 10 440, date 07.07.2011.

VNM gjithashtu perfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

1.1 Objektivat afatshkurter te VNM-se jane:

- ❖ Përmirësim nga pikëpamja mjedisore te projektit te propozuar;
- ❖ Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
- ❖ Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
- ❖ Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
- ❖ Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.

- ❖ Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
- ❖ Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
- ❖ Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
- ❖ Të japë informacion mbi vendndodhjen e objektit dhe të analizojë tiparet mjedisore.
- ❖ Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- ❖ Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- ❖ Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.

Objektivat afatgjate të VNM-se janë:

- ❖ Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- ❖ Përmirëson aspektet sociale-ekonomike të projektit;
- ❖ Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

Përshkrim i metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VNM-se.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kryhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

1.2 Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-te dhe zhvillimeve të fundit në fushën e ndërtimit dhe industrisë.

Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Perveç Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratori edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”. Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me VNM-ne dhe mjedisin përfshijnë:

1. Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, të ndryshuar;
2. Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 ‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’, të ndryshuar;
Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”
3. Ligji Nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.
4. Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
5. VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 ‘Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore’;
6. VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
7. Ligji Nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
8. VKM Nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
9. VKM Nr.175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”
10. VKM Nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”
11. VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”
12. VKM Nr. 229, datë 23. 04. 2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”
13. VKM Nr.519, datë 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
14. VKM Nr.897. datë 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes”
15. VKM Nr. 532, datë 05.10.2000 “Për miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin”

16. VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”
17. VKM Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
18. Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
19. VKM Nr 352, datë 29.04.2015. “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.
20. VKM Nr 177 date 31.3.2005 ‘Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese’
21. VKM Nr. 402, date 30.06.2021 “Per miratimin e katalogut te mbetjeve”
22. Udhezim Nr.8 date 27.11.2007 per ‘Nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.’

1.3 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) ”Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO², NO_x, SO², lëndët grimcore dhe Pb në ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEE/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla.
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Proceset teknologjike në këtë projekt lidhen me fazën ndërtimore, përmes realizimit të punimeve të mbrojtjes lumore, të cilat do të kryhen nga firma zbatuese e projektit përgjatë brigjeve të lumit, me qëllim stabilizimin e skarpateve, mbrojtjen nga erozioni dhe disiplinimin e rrjedhës së ujit.

Disa prej proceseve kryesore të punimeve ndërtimore do të jenë:

- Rrethimi dhe organizimi i kantierit të ndërtimit;
- Pastrimi i zonës së ndërhyrjes nga bimësia e pakontrolluar, depozitimet inerte, mbetjet dhe elementët që pengojnë realizimin e punimeve;
- Gërmimet dhe përgatitja e terrenit për realizimin e strukturave të mbrojtjes lumore;
- Sistemimi dhe profilizimi i brigjeve dhe shtratit të lumit në segmentet e projektuara;
- Ndërtimi i strukturave mbrojtëse me gabiona, penela, mure mbajtëse dhe elementë të tjerë hidroteknikë për mbrojtjen nga erozioni dhe stabilizimin e brigjeve;
- Vendosja e shtresave filtruese, materialeve mbushëse dhe elementëve drenazhues sipas projektit teknik;
- Stabilizimi i skarpateve dhe disiplinimi i rrjedhës së ujit për të parandaluar dëmtimet nga prurjet dhe gërryerjet;
- Sistemimi i zonave përreth dhe i rrugëve të aksesit për nevojat e mirëmbajtjes dhe monitorimit të veprës;
- Rehabilitimi dhe gjelbërimi i zonave të prekura nga punimet, në përputhje me masat mjedisore të parashikuara në projekt.

Ngritja e Kantierit

Ne kete projekt permblidhen nje numer i madh detyrash pa te cilat nuk mund te arrihet zhvillimi normal i punimeve ne sheshin per mbrojtjen lumore.

Ne kete projekt pasqyrohen:

- Rrethimi i territorit (hapsires se lire)
- Rruget e qarkullimit te brendshem
- Sheshet e depozitimit te materialeve
- Stacioni i makinerive ngritese

Rrethimi i perkohshem i sheshit te ndertimit gjate periudhes se zhvillimit te punimeve eshte i domosdoshem. Ky rrethim i behet zones se ndertimit per te mbrojtur kalimtarete dhe per te evituar te papriturat qe mund te vijne nga mjetet dhe mekanizmat qe kryejne punimet. Rrethimi sherben dhe per te ruajtur materialet qe perdoren ne veper si edhe punimet e kryera. Rrethimet e perkohshme zbatohen te thjeshta por te qendrueshme me pare. Ky rrethim mund te behet duke perdorur materiale te perdorura me pare. Ky rrethim zbatohet me shtylla metalike cdo 2m si dhe llamarine te valezuar.

Figura Nr.2. Planvendosja




Figura Nr. 3 Planimetria



2.1 Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes bimore ku propozohet të ndërtohet projekti dhe fotografitë përkatëse.

Berati është një nga qytetet më të rëndësishme historike dhe kulturore të Shqipërisë dhe njëkohësisht qendër e qarkut me të njëjtin emër. Qyteti njihet për vlerat e tij arkitekturore dhe urbanistike dhe është pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Berati ndodhet në pjesën jug-qendrore të vendit dhe zhvillohet përgjatë brigjeve të Lumi Osum, i cili përshkon qytetin dhe ndikon drejtpërdrejt në karakteristikat hidrologjike dhe zhvillimin urban të zonës.

Relievi i zonës karakterizohet nga kombinimi i ultësirave përgjatë lumit me kodrat dhe formacionet shkëmbore përreth qytetit. Berati kufizohet nga zona kodrinore dhe malore që krijojnë pjerrësi të theksuara drejt shtratit të lumit, duke ndikuar në rrjedhën dhe intensitetin e prurjeve gjatë periudhave me reshje. Qyteti ndodhet në një lartësi mesatare rreth 58–70 m mbi nivelin e detit dhe karakterizohet nga klimë mesdhetare, me dimra të lagësht dhe vera të nxehta e të thata.

Lumi Osum përbën elementin kryesor hidrografik të zonës dhe ka ndikim të rëndësishëm në jetën urbane dhe zhvillimin ekonomik të qytetit. Gjatë periudhave me reshje intensive dhe prurje të larta, segmentet pranë brigjeve paraqesin rrezik nga erozioni dhe përmytjet, veçanërisht në zonat e banuara pranë lumit, si Lagjja Bejdollar. Për këtë arsye, realizimi i veprave mbrojtëse lumore paraqitet i domosdoshëm për

garantimin e sigurisë së banorëve, mbrojtjen e infrastrukturës ekzistuese dhe ruajtjen e stabilitetit të brigjeve të lumit.

Habitatet dhe Biodiversiteti

Karakteristikat topografike, hidrologjike, gjeologjike dhe prania e aktivitetit njerëzor në zonën e projektit ndikojnë në formimin e habitateve tipike urbane dhe gjysmë-natyrore përgjatë brigjeve të Lumi Osum. Duke u bazuar në kushtet ekzistuese të territorit, karakteristikat hidrogeologjike, klimën dhe relievin e zonës, realizimi i veprës së mbrojtjes lumore nuk pritet të sjellë ndryshime të konsiderueshme në biodiversitetin, peizazhin natyror apo ekosistemet ekzistuese të zonës. Zona ku parashikohet ndërhyrja karakterizohet kryesisht nga sipërfaqe të menaxhuara dhe të ndikuara nga aktiviteti urban dhe infrastruktura ekzistuese, me prani të kufizuar të bimësisë spontane përgjatë brigjeve.

Flora

Vegetacioni në zonën e ndërhyrjes përfaqësohet kryesisht nga bimësi barishtore spontane, shkurre të ulëta dhe specie tipike të zonave lumore dhe urbane. Në segmentet përgjatë brigjeve vërehet prani e shpërndarë e bimësisë spontane, pa vlera të veçanta floristike, industriale apo medico-aromatike. Nuk janë evidentuar specie bimore endemike, të mbrojtura apo të rrezikuara sipas legjislacionit dhe konventave ku aderon Republika e Shqipërisë. Ndërhyrja e projektuar nuk pritet të sjellë ndikime të rëndësishme mbi florën ekzistuese, pasi punimet do të kufizohen kryesisht në zonën e degraduar të brigjeve të lumit.

Fauna

Zona në studim nuk dallohet për biodiversitet të pasur faunistik për shkak të zhvillimit urban, pranisë së vazhdueshme të aktivitetit njerëzor dhe kushteve të kufizuara të habitatit natyror. Fauna përfaqësohet kryesisht nga specie të zakonshme të zonave urbane dhe periurbane. Realizimi i projektit nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme mbi faunën ekzistuese, pasi ndërhyrjet janë të lokalizuara dhe me karakter stabilizues e mbrojtës të brigjeve.

Klima dhe cilësia e ajrit

Berat karakterizohet nga klimë mesdhetare me dimra të butë dhe me reshje, si dhe vera të nxehta dhe të thata. Reshjet janë më intensive gjatë periudhës së dimrit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në regjimin hidrologjik të Lumi Osum. Temperatura mesatare vjetore dhe kushtet klimatike të zonës favorizojnë zhvillimin urban dhe aktivitetin ekonomik. Cilësia e ajrit në zonë ndikohet kryesisht nga trafiku urban dhe aktivitetet ekzistuese, ndërsa gjatë fazës së ndërtimit të projektit ndikimet do të jenë të përkohshme dhe të kontrolluara nëpërmjet masave për reduktimin e pluhurave dhe emetimeve.


Hidrogeologjia

Zona e projektit ndikohet drejtpërdrejt nga regjimi hidrologjik i Lumi Osum dhe nga prania e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore përgjatë brigjeve të lumit. Terreni përbëhet kryesisht nga depozitime aluviale dhe materiale sedimentare me përshkueshmëri të ndryshme, të cilat janë të ekspozuara ndaj fenomenit të erozionit dhe gërryerjes gjatë prurjeve të larta. Punimet e gërmimit dhe realizimit të strukturave mbrojtëse do të shoqërohen me masa teknike për kontrollin e ujërave dhe stabilizimin e terrenit.

Zonat e mbrojtura

Në zonën e projektit dhe në afërsinë e saj nuk evidentohen zona të mbrojtura mjedisore apo monumente natyrore që preken drejtpërdrejt nga realizimi i veprës. Projekti është konceptuar në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet në mjedis dhe të ruajë karakteristikat natyrore dhe peizazhin urban të zonës.

AKZM - RAJONI BERAT






Figura Nr.4 Hidrologjia

Fenomeni erozionit

Ne zonen e studjuar ka disa perroska te vogla te cilat ne momentin e reshjeve massive krijojne rryma ujrash siperfaqesore te cilat kane attesi te gerryejne ne mbulesen deluvialo eluviale. Ky nuk eshte nje fenomen shume problematik, por duhet patur parasysh ne projektin e ketij objekti linear per te sistemuar ujrat siperfaqesore qe krijohen ne momentin e reshjeve masive.

Tektonika dhe Sizmiciteti lokal

Duke qene se eshte nje ngjarje e mundshme, per te bere nje vleresim sa me te sakte duhet qe nga ana statistikore te punohet nje numer sa me i madh ngjarjesh sizmike. Ne kendveshtimin sizmik, projektimi dhe ndertimi i themeleve dhe i lidhjeve me strukture siper tyre duhet te siguroj ate qe e gjithë ndertesa t'i nenshtrohet nje veprimi uniform sizmik.




Figura Nr.6 Harta Zonave te Mbrojtura




Figura Nr. 7 Tregon distancën me zonën e mbrojtur me të afërt




Figura Nr. 8 Tregon distancën me monumentet e natyres




Figura Nr.9 Harta e zonave të mbrojtura në shqipëri

Projekti ne fjale sic duket edhe ne hartat e mesiperme, ka nje distance te konsiderueshme nga zona e mbrojtur si dhe nga monumentet e natyres dhe nuk prek asnje nga nenzonat e siperpermendura.



Figura Nr. 10 distancat me zonat e banuara

Sic duket edhe nga *Figura Nr. 10* vendi ku do te kryhen punimet, ndodhet i distancuar nga zonat e banuara.

2.2 Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e zënë nga projekti dhe ne afërsi të tij.

Gjurma e objektit të propozuar ruan distancat si nga rruga si nga objektet e tjera që ndodhen në zonë.

Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore

Aktiviteti në fjalë ndodhet në një zonë rurale me karakter kryesisht bujqësor dhe me dendësi të ulët objektesh ndërtimore. Zona përreth përbëhet nga toka bujqësore dhe sipërfaqe me aktivitet blegtoral, ndërsa shtresëzimet gjeologjike të pranishme nuk paraqesin ndjeshmëri të lartë ndaj ndotjeve potenciale, për aq kohë sa zbatohen masat mbrojtëse dhe teknike të parashikuara në projektin e mbrojtjes lumore.

Megjithatë, gjatë fazës së ndërtimit ekziston mundësia e ndikimeve të përkohshme mbi ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, kryesisht si pasojë e aktiviteteve ndërtimore, përdorimit të makinerive dhe lëvizjes së mjeteve të transportit. Në fazën e operimit të veprës nuk parashikohen shkakime të lëngëta apo procese që gjenerojnë ndotje të vazhdueshme të ujërave.

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat ujore, të lidhura me aktivitetet përgatitore të sheshit dhe punimet ndërtimore për realizimin e mbrojtjes lumore, përfshijnë:

- Rritjen e përkohshme të pezullive në ujë si rezultat i gërmimeve, sistemimit të brigjeve dhe punimeve në afërsi të shtratit të lumit;
- Rrezikun e mundshëm të ndotjes nga derdhje aksidentale të karburanteve, vajrave lubrifikues apo materialeve të tjera nga makineritë dhe mjetet e transportit që operojnë në kantier;
- Mundësinë e transportimit të materialeve inerte dhe mbetjeve ndërtimore drejt rrjedhës ujore gjatë periudhave me reshje;
- Ndikime të përkohshme në cilësinë e ujërave sipërfaqësore si pasojë e punimeve tokësore, stabilizimit të brigjeve dhe vendosjes së strukturave mbrojtëse hidroteknike.

Në tërësi, ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore dhe në mjedisin përreth janë vlerësuar si ndikime me intensitet të ulët, me probabilitet të moderuar dhe me shtrirje lokale, të kufizuara vetëm gjatë fazës së ndërtimit dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave mbrojtëse dhe monitoruese të parashikuara në projekt.

2.3 Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve

vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- ❖ Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes se integruar
- ❖ Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- ❖ Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujerave
- ❖ Mbrojtja e tokes
- ❖ Mbrojtja e natyres
- ❖ Ndryshimet klimatike

Projekti ne fjale do te kryhet mbi nje siperfaqe toke private ne te cilen nuk ka bimesi te larte, nuk ka park natyror, nuk ka demtime te bimesise se zones.

Bazuar ne llojin e projektit te propozuar ndikimet me thelbësore mund te analizohen vetem sipas fazes se ndertimit:

Rendesi ka te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte apo indirekte, ne menyre qe te percaktohet qarte lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen ne toke te ketyre ndikimeve, ato klasifikohen ne:

- ❖ Ndikime te kthyeshme ne mjedis
- ❖ Ndikime te pakthyeshme ne mjedis

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- Ndikimet kryesore ne mjedis nga ndertimi dhe funksionimi i ketij projekti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- ## Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne faze te ndertimit te projektit

Tabela Nr. 4

Raport Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Toke	Ngjeshje e tokes	Si pasoje e levizjes se makinerive dhe mjeteve qe frekuentojne kete aktivitet, do te kemi ngjeshje te tokes ne sektore te vecante te saj. Mund te kemi ndotje eventuale te tokes nga derdhje aksidentale te lubrifikanteve/ karburantit te makinerive dhe mjeteve te transportit.
	Erozion i tokes	Si pasoje e operacioneve ndertimore dhe pershtatjes se sheshit te ndertimit do te realizohen punime germuese per hapjen e gropave si pasoje e te cilave do te gjenerohet nje sasi e konsiderueshme dherash por qe do te riperdoren perseri.
	Ndotje e tokes	Gjate fazes se ndertimit, do te kemi sjelljen e lendes se pare qe do te perdoret per rikonstruksionin e kanalit. Nuk pritet te kete ndotje te tokes pasi transporti dhe vendosja e elementeve do te behen me makineri bashkekohore dhe automatike.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Ndikimet e mundshme negative ne ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Nuk pritet ndikim ne cilesine e ujerave nentokesore.
Ajer	Emisione gazesh	Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. - Mjetet e transportit qe transportojne paisjet per, mjetet qe terheqin mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve.
	Aromat	Faza e ndertimit nuk shoqerohet me aroma te renda dhe bezdisese, si per punetoret ashtu dhe per banroret e zonave perreth.
	Zhurme, vibrime	Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate transportimit te produkteve. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise. Theksojme se zona nuk ka nje flore dhe faune te mbrojtur me ligj.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones	Ne afersi te zones se punimeve nuk ka zona te banuara, dhe pse nga ndertimi qe do te kryhet do te kete shqetesim

		minimal vetem ne fazen e ndertimit.
Menaxhi mi i mbetjeve	Ndikim ne mjedisin e zones	Mbetjet qe do te gjenerohen nga ky aktivitet vleresohet te vetem mbetje urbane si kartona, qese dhe ambalazhe te lendes se pare qe sherben per ndertimin e penelave dhe gabione, keto do te mblidhen dhe ne fund te dites se punes do te largohen per ne vendet e percaktuara nga Pushteti Vendor.
Ndikimet te tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Aktiviteti mund te ndikojë ne shtimin e trafikut te zones vetem gjate fazes se transportit te paisjeve dhe pse kjo do te jete ne nivele te moderuara. Keshillohet te punohet ne orare te cilat te mos sjellin shqetesime per banoret dhe trafikun.
	Konsumi i energjise	Energjia elektrike do te sigurohet nga burime te riperteritshmes panelle diellore
	Siguria dhe ndikimet ne shendet	Kushtet e punës në mjediset ku punohet do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të punës. Mjedis i qëndrimit dhe i punës për punëtorët do të jetë i përshtatshëm, i pastër, i sigurt, për të siguruar nevojat bazë të punonjësve. Kompania zbatuese do të jetë përgjegjëse për Shendetin dhe Planin e Sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Investitori do të shqyrtojë dhe të miratojë këto plane dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e performances së zbatuesit. Të gjithë punëtorët do të trajnohen në lidhje me rregullat dhe procedurat e e duhura të sigurisë.
	Ndikime social-ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsisë se zones nga punesimi.

2.4 Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis

Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte:

1. Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te gjate ndertimit dhe montimit, gazet e mjeteve te transportit.
2. Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut dhe ujerat e zeza nga aktiviteti i punonjeseve gjate shfrytezimit, per shkarkimet e ketyre ujerave do te ndertohet nje grope septike brenda

ambjenteve te aktivitetit e cila do te pastrohet ne bashkepunim me instancat perkatese sa here qe te jete nevoja.

3. Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohej.
4. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, dhe nga transporti i materialeve.

Shkarkimet ne ajer

Emetimet në ajër gjatë realizimit të punimeve të mbrojtjes lumore lidhen kryesisht me përhapjen e pluhurave dhe gazrave të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore, gërmimet, transporti i materialeve inerte dhe funksionimi i makinerive të rënda në kantier. Pluhurat krijohen kryesisht gjatë gërmimeve, sistemimit të brigjeve, transportit dhe shkarkimit të materialeve, si dhe gjatë lëvizjes së mjeteve në rrugët e pa asfaltuara të aksesit. Megjithëse pluhuri nuk pritet të shkaktojë ndryshime afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, depozitimi i tij në zonat përreth mund të krijojë shqetësime të përkohshme për mjedisin dhe aktivitetet pranë kantierit.

Këto ndikime konsiderohen të përkohshme dhe kufizohen kryesisht gjatë fazës së ndërtimit të veprës së mbrojtjes lumore. Grimcat pezull në atmosferë (PM10 dhe PM2.5) mund të transportohen në distanca të kufizuara nga era, veçanërisht gjatë periudhave të thata dhe në momentet me intensitet të lartë punimesh. Burimet kryesore të këtyre grimcave janë proceset e gërmimit, ngarkim-shkarkimit të materialeve, lëvizja e automjeteve dhe funksionimi i makinerive të ndërtimit.

Për shkak të dimensioneve të vogla, grimcat PM10 mund të depërtojnë në sistemin respirator gjatë frymëmarrjes dhe të paraqesin ndikim potencial për shëndetin e punonjësve dhe banorëve në afërsi të kantierit, megjithatë ndikimi pritet të jetë i kufizuar, afatshkurtër dhe lokal.

Emetimet e gazeve gjatë punimeve të mbrojtjes lumore lidhen kryesisht me funksionimin e makinerive të rënda, automjeteve të transportit dhe pajisjeve me motorë me djegie të brendshme. Ndotësit kryesorë që mund të emetohen janë:

Monoksidi i karbonit (CO);

Oksidet e azotit (NO_x, veçanërisht NO₂);

Dioksidi i karbonit (CO₂);

Grimcat e imta PM10 dhe PM2.5;

Komponimet organike të paqëndrueshme (VOC);

Sasi të vogla hidrokarburesh dhe gaze të tjera nga djegia e karburanteve.

Për shkak se aktiviteti zhvillohet në një mjedis rural dhe të hapur, me qarkullim natyror të ajrit dhe pa përqendrim të lartë aktivitetesh industriale apo urbane, nuk parashikohet që emetimet të

shkaktojnë tejkalime të standardeve të cilësisë së ajrit apo ndikime të rëndësishme jashtë kufijve të kantierit. Ndikimet janë vlerësuar si lokale, të përkohshme dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave për kontrollin e pluhurave dhe mirëmbajtjen e rregullt të makinerive të ndërtimit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes së aktivitetit

Nuk do të ketë burime potenciale shkarkime ndotese në ajër.

Ujërat nëntokësore

Në zonë nuk ka puse hidrogeologjike të hapura në akuiferet kuaternare zhavoreve të zonës për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë, për pasojë nuk ka ndjeshmëri për ndikimet e mundshme të aktiviteteve të projektit në ujërat nëntokësore.

Megjithatë marrja e masave për ndalimin e shkarkimeve ndotese është e rëndësishme. Nëse nuk merren masa, ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore janë vlerësuar me nivelit, të ulët si dhe probabilitet e madhësi të moderuar. Gjatë fazës së operimit, ne qoftë se nuk zbatohen kushtet dhe masat sipas projektit, ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore janë vlerësuar me nivel, probabilitet e madhësi të moderuar.

Por në aktivitetin në fjalë do të merren të gjitha masat e nevojshme nëse do të ketë raste aksidentale duke e vlerësuar gjënë me ndikim normal e të moderuar.

Zhurmat dhe vibrimet

Gjatë fazës së ndërtimit në zonë priten të regjistrohen nivele relativisht të larta të zhurmës. Nivele të konsiderueshme të zhurmës dhe vibrimeve pritet të shkaktohen kryesisht nga përdorimi i pajisjeve të rënda, duke përfshirë dhe kamionët që transportojnë elementet dhe strukturat mbajtëse dhe mbetjet e gjeneruara gjatë përgatitjes së sheshit dhe veprimtarive të ndërtimit për projektin në fjalë. Shqetësimet që rezultojnë nga zhurmat e ndërtimit nuk mund të përjashtohen duke pasur parasysh se zona e projektit është jo shumë e populluar. Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga mjetet rrugore, zhurma e prodhuar nga vetë personat që do të punojnë për këto aktivitete, proceset e vendosjes dhe montimit të paneleve, etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit. Kjo duhet të kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Nuk do të shkaktohen vibrime shqetsuese gjatë punimeve.

Për të reduktuar këto ndikime tek banesat pranë, subjekti ndërtues, nuk duhet të punojë gjatë orëve të vona ku niveli i lejuar i zhurmave është më i ulët dhe fonja në rrugë apo aktiviteteve të tjera është më e ulët.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen nga punimet ne kete zone mbetjet e dheut te germuar, materiale te ndertimit duhet te trajtohen ne menyre te veçante. Ne rastin e gjenerimit te mbetjeve jo te perdoreshme ateher duhet te bashkepunohet me nje subjekt te licensuar dhe te paisur me License III.2.B sipas shtojces nr.1 te ligjit nr 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” ose ne shesh depozitimet e perkoshme te percaktuara nga Bashkia Shkoder ne perputhje me VKM 229 date 23.04.2014” Per menyren e transferimit te mbetjeve jo te rezikshme”, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e mbrojtjes lumore, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, i cili krijon mbetje.

Sipas VKM Nr.402 date 30.06.2021 “Per miratimin e katalogut te mbetjeve” mbetjet te cilat parashikohen te krijohen gjate ndertimit jane:

Kodi 20 03 01 Mbetjet e perziera urbane

Kodi 15 01 01 Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni

Kodi 15 01 02 Mbetje ambalazhi plastike

Kodi 15 01 04 Mbetje ambalazhi metalike

Në fazën ndërtimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë ai i ndërtimit të këtij aktiviteti, dhe mbetjet e krijuara nga konsumi i perditshem i punëtorëve. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të punimeve për mbrojtjen lumore. Mbetjet urbane në kete rast do te menaxhohen ne bashkepunim me Pushtetin Vendor.

Subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet e kesaj zone, dhe pse nuk kemi te bejme me nje zone te ndjeshme, duke marre ne konsiderate dhe parimin “ndotesi pagan”.

2.5 Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara

Punimet ndërtimore për realizimin e projektit të mbrojtjes lumore parashikohet të zhvillohen për një periudhë të caktuar kohore, në varësi të kushteve teknike, klimatike dhe organizative të zbatimit të punimeve. Në kushte normale teknike, juridike dhe klimatike, punimet pritet të realizohen

brenda afateve të përcaktuara në projekt dhe kontratë, ndërsa në raste të veçanta, si prurje të larta ujore, reshje intensive, vështirësi gjeoteknike apo problematika të paparashikuara gjatë zbatimit, mund të ketë shtyrje të afateve të realizimit të punimeve.

Si rrjedhojë, edhe ndikimet e fazës ndërtimore do të jenë të pranishme për aq kohë sa do të zgjasin punimet për realizimin e veprës së mbrojtjes lumore. Këto ndikime konsiderohen të përkohshme dhe lidhen kryesisht me aktivitetet e gërmimit, sistemimit të brigjeve, transportit të materialeve, funksionimit të makinerive dhe organizimit të kantierit.

Përsa i përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit, ato do të jenë të pranishme për aq kohë sa vepra e mbrojtjes lumore do të jetë në përdorim. Megjithatë, pas përfundimit të punimeve, ndikimet në mjedis pritet të jenë minimale, pasi vepra nuk gjeneron shkarkime, emetime apo procese industriale gjatë operimit. Përkundrazi, funksionimi i saj do të sjellë efekte pozitive në stabilizimin e brigjeve, reduktimin e erozionit dhe mbrojtjen e territorit nga përmbytjet dhe dëmtimet hidraulike.

Ndikimi në peizazh do të jetë i përkohshëm gjatë fazës së ndërtimit, për shkak të pranisë së makinerive, materialeve dhe aktiviteteve të kantierit, ndërsa pas përfundimit të punimeve ndikimi do të jetë i përhershëm vetëm në aspektin e pranisë së strukturave të mbrojtjes lumore në territor. Ky ndryshim konsiderohet i integrueshëm me karakterin natyror të zonës dhe me funksion mbrojtës për mjedisin dhe infrastrukturën përreth.

2.6 Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit të mbrojtjes lumore, distanca e ndikimit në mjedis pritet të jetë e kufizuar dhe të shtrihet kryesisht në zonën përreth segmentit ku do të realizohen punimet, veçanërisht gjatë fazës së ndërtimit. Ndikimet potenciale lidhen kryesisht me aktivitetet e gërmimit, sistemimit të brigjeve, transportit të materialeve dhe funksionimit të makinerive të ndërtimit, por në përgjithësi ato nuk pritet të shtrihen jashtë territorit ku zhvillohet ndërhyrja.

Burimet kryesore të vibrimeve dhe zhurmave gjatë realizimit të punimeve do të jenë makineritë e ndërtimit, kamionët dhe mjetet e transportit që do të përdoren për furnizimin dhe lëvizjen e materialeve në kantier. Këto ndikime do të jenë të përkohshme, me intensitet të moderuar dhe të kufizuara kryesisht pranë zonës së punimeve.

Ndikimi në mjedisin e zonës pritet të shfaqet në një distancë të kufizuar, kryesisht në dhjetëra deri në disa qindra metra nga kantieri, dhe në përgjithësi jo më larg se rreth 200–300 m nga segmentet ku kryhen ndërhyrjet. Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe pa karakter akumulues në mjedis.

Gjatë fazës së funksionimit të veprës së mbrojtjes lumore nuk parashikohen shkarkime apo emetime të dëmshme për mjedisin ujor, ajrin, tokën apo biodiversitetin, pasi vepra nuk përfshin procese industriale apo teknologjike që gjenerojnë ndotje. Përkundrazi, realizimi i projektit pritet të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e brigjeve, reduktimin e erozionit dhe mbrojtjen e territorit përreth nga dëmtimet hidraulike.

Ndikimi në peizazh do të jetë i përkohshëm gjatë fazës së ndërtimit, për shkak të pranisë së makinerive, materialeve dhe organizimit të kantierit, ndërsa pas përfundimit të punimeve ndikimi do të jetë i përhershëm vetëm në aspektin e pranisë së strukturave të mbrojtjes lumore të integruara në terren.

Nga analiza e të gjithë faktorëve me ndikim në mjedis rezulton se punimet për realizimin e projektit të mbrojtjes lumore nuk do të kenë shtrirje të konsiderueshme hapësinore të ndikimeve negative, por këto ndikime do të mbeten të kufizuara kryesisht brenda zonës së ndërhyrjes dhe territorit ku zhvillohen punimet.

Vlerat e ndikuara

Biodiversiteti

Duke qënë se vendi ku do të ndertohet objekti është sipërfaqe toke ne pronesi private në një zonë jo shume te zhvilluar urbane nga të gjitha anët, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta për sa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale urbane dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i papërfillshëm.

Fauna

Ndikimet ne faunë jane te ulët e jo te rëndësishme, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmave, që ndodhen në popullata të rregullata e të qëndrueshme osë që janë veçanërisht të ndjeshëm, të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër. Ndikimi negativ në kafshët e egra eshte i papërfillshëm pasi ne te nuk ka kafshe te tilla.

Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i kthyeshëm. Jovertebrоре,

amfibet dhe zvarraniket.

Dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin e drejtpërdrejtë të individëve rastësore, si dhe faunës jovertebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet e ulët dhe e papërfillshme.

Ujra nëntoksore

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të ulët, të madhësisë së ulët. Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.

Ujrat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

Ndikimet në tokë

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar të një probabiliteti të ulët duke marrë parasysh tjetërsimin e përdormit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin racional të rrugëve ekzistuese hyrëse. Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet i një rëndësie të papërfillshme si dhe në masë të vogël.

Ndikimi në ajër

Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyes, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale.

Ndikimi nga zhurmat

Zhurma gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si kamionet, etj, për të cilat ka matje të caktuara të nivelit të zhurmës së tyre. Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë të krijuar. Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Urdherin Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmat në mjedise të caktuara". Nuk ka asnjë ndikim negativ të parashikuar për banorët përreth nga zhurma e gjeneruar gjatë fazës së ndërtimit por edhe gjatë fazës së operimit.

Ndikimi nga vibrimet

Vibrimet gjenerohen kryesisht gjatë aktivitetit të ndërtimit, nga levizja e mjeteve të transportit që

transportojne materialet per ndertim. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm të perceptueshme. Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ato janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogël dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.

Ndikimet në pejsazh dhe vizualitet.

Gjatë fazës parapregatitore të terrenit dhe atë të punimev për mbrojtjen lumore, ndikimi vlerësohet me probabilitet të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të objektit si element zhvëllimor urban më objektet e tjera të ngjashme egzistuese. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm mund të vlerësohet i një rëndësie të ulët.

Gjenerimi i mbetjeve

Mbetjet e ngurta të gjeneruara nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme të rehabilitimit të shesheve do të merret sic duhet.

2.7 Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga rëndësia e aktivitetit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompensime indirekte mbi komunitetin.

Subjekti investitor, duhet që pas perfundimit të ndërtimit të projektit në fjalë dhe infrastruktures perkatese, të kryejë rehabilitimin e plote të sipërfaqeve të lira, si ato të shtruara me beton ose pllaka, për rrugët hyrese, sheshet e parkimit dhe për sipërfaqet e gjelberta. Duhet të mbillet bimësi në perimetrimin e pronës për të reduktuar ndikimin në pejsazh, si dhe brenda mundësive të mbillen bimët që i rezistojnë këtyre kushteve klimaterike, pra bimë autoktone.

Sipërfaqja e lirë e pronës të shndërrohet në një mjedis të pastër dhe të sigurt.

Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemimit të terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjëlberimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shëndetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin e rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike. Sistemimi i sheshit të ndertimit të projektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike të këtij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngusht me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit.

Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të punimeve përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë shërbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve të projektit.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve nga territori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Ndalimi i çdo veprimtarie që ka të bëjë direkt ose indirekt me aktivitetin në fjalë.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rehabilitimin e plotë të zonës. projektit, koridoret qarkulluese e të shërbimeve të mirembajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike.

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar urban me funksion të shumfishtë ripërtitës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishëm ka në përmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke përmirësuar aspektin pamor.

Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe kthimi i tij në gjendjen e mëparshme konsiderohet e realizueshme në masë të konsiderueshme për projektin e mbrojtjes lumore. Pas përfundimit të punimeve ndërtimore do të kryhet pastrimi i plotë i kantierit, largimi i mbetjeve ndërtimore, materialeve të tepërta dhe elementëve të përkohshëm të përdorur gjatë zbatimit të punimeve.

Gjithashtu, zonat e prekura përkohësisht nga aktiviteti ndërtimor, si rrugët e aksesit, sipërfaqet e depozitimit apo segmentet anësore të ndërhyrjes, do të sistemohen dhe rehabilitohen në përputhje me projektin dhe masat mjedisore të parashikuara. Në segmentet ku është e mundur do të realizohet edhe gjelbërimi dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara gjatë punimeve.

Megjithatë, nuk mund të pretendohet rikthimi i plotë i territorit në gjendjen e tij të mëparshme natyrore në zonat ku do të ndërtohen strukturat e përhershme të mbrojtjes lumore, si gabionet, penelat, muret mbrojtëse apo veprat e tjera hidroteknike. Këto ndërhyrje do të mbeten pjesë e përhershme e territorit, por janë projektuar në mënyrë që të integrohen sa më mirë me konfigurimin natyror të zonës dhe të kontribuojnë në stabilizimin e brigjeve, mbrojtjen nga erozioni dhe përmirësimin e sigurisë hidraulike të lumit.

Kostot financiare të përafërta për rehabilitimin

Kostot financiare të rehabilitimit janë të përfshira në kostot e punimeve për mbrojtjen lumore, pasi rehabilitimi dhe sistemimi i mjedisit është pjesë e projektit.

2.8 Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori ose nënkontratuesit për zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë përmendur në mënyrë të përbledhur si më poshtë:

Masat lehtësuese që do të ndermerren gjatë punimeve të ndërtimit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhenien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit perben në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të ndermerren nga investitori për ndërtimin e parkut fotovoltai. Në fazën fillestare të punimeve, do të kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitjen për fillimin e punimeve.

Masat që duhet të adoptohen për të minimizuar pluhurin gjatë ndërtimit përfshijnë:

- ❖ Mbylljen ose rrethimin e vendeve të ndërtimit.
- ❖ Shpërndarjen e ujit në forme shiu në rrugët e pluhurosura.
- ❖ Të gjitha makineritë dhe automjetet e transportit duhet të veprojnë në përputhje me standardet relevante për automjetet dhe të kenë mirëmbajtjen e duhur për të minimizuar ndotjen e ajrit.
- ❖ Përdorimi i lendeve djegëse, të cilat janë në përputhje me standardet zyrtare (sipas Urdhrit Nr.6, nga 09.10.2007, përmbajtja e sulfurit në naftë, duke filluar nga 01.01.2011 duhet të jete 10 mg max/kg).
- ❖ Kontrolli i shpejtësisë së automjeteve, si dhe zgjedhja e rrugëve të transportit për të minimizuar ndikimin nga pluhuri.

- ❖ Minimizimi i kohës së qëndrimit në vend-ruajtje apo magazinim të materialeve të ndërtimit si strukturat mbajtëse.
- ❖ Monitorimi i cilësisë së ajrit në bazë të VKM Nr.435, të 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër, në territorin e Shqipërisë", VKM Nr 803, dhjetor 2003, "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe VKM Nr 103, i 31.3.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë". Udhëzimi Nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre" përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye.
- ❖ Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rrezikun nga pluhuri dhe të tjera substancave ndotëse.

Ndikimi i aktivitetit të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit është i perkohshëm, i kthyeshem, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të aktivitetit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Ndikimi në cilësinë e ajrit do të bëhet i pranueshem pothuajse i paperfillshëm gjatë fazës së funksionimit të projektit.

Masat kryesore për ruajtjen e floras/faunës.

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të zihet nga projekti në fjalë, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si gjelbërimi përreth territorit të objektit por për këtë do të komunikohet me parë me specialist të fushës, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth:

- ❖ Të mos demtohet fauna e zonës duke e mbrojtur atë kur është në rrezik.

Masat kryesore për zvogëlimin e zhurmave do të përfshijnë:

- ❖ Asnjë punim ndërtimi gjatë natës me makineri të rënda, nga ora 22:00 në orën 06:00 afër zonave të banuara, ndonëse vendi ku do të implementohet projekti në fjalë ndodhet larg qendrës së banuar.
- ❖ Mirëmbajtje dhe funksionimin e duhur të makinerive të ndërtimit për të minimizuar burimin e zhurmës.

Masat kryesore per trajtimin e ujerave:

Ujerat nentokesore

Është e nevojshme marrja e masave të përgjithshme të praktikës së mirë të ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat nëntokësore, gjatë përgatitjes dhe fazat e ndërtimit. Shmangia sa më shumë që të jetë e levizjes së lire të ujërave të bardha jashtë sistemit drenues të ndërtuar për qarkullimit të tyre. Nëse merren këto masa zbutëse, ndikimet e mundshme mund të reduktohet në një probabilitet të papërfillshëm dhe të rëndësisë vetëm lokale. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta duhet të zbutet duke aplikuar praktikatat më të miran për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Ujerat sipërfaqesore

Eshtë e nevojshme zbatimi i një sërë masash të përgjithshme të praktikës së mirë të ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit të projektit. Duhet të merren masa zbutëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ujërat e zeza dhe nga mbetjet e ngurta që ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore mund të reduktohet në një rëndësie të papërfillshme, dhe në masë lokale. Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonën e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët më shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikatat e duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.

Masat zbutese per zhurmat lidhen me respektimin e standarteve ligjore gjate ndertimit e operimit te objektit te propozuar. Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë krijuar. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen si më poshtë:

- Dita zgjat 13 orë, nga ora 06:00 deri në 19:00;
- Mbrëmja zgjat 4 orë, nga ora 19:00 deri në 23:00; dhe
- Nata zgjat 7 orë, nga ora 23:00 në 06:00.

Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Rregulloren e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmave në mjedise të caktuara".

Tabela Nr.3: Nivelet e brezit të zhurmës në varësi të mjedisit (sipas Udhezimit Nr.8, date 27.11.2007 per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara).

Tabela Nr.5: Nivelet kufi te zhurmes per mjedise te caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA_{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes	35	16	
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare hapur (vlere nga jashte)	45	8	
Institucione				
Klasa mesimi institucione-mjedise parashkollore (Brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshtiresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	
Dhoma e fjetjes ne kopeshte (Brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	
Obori i shkolles, vendet e lojrave ne shkolle	Bezdi (shqetesim)-Burime te jashtme	55	Koha e pushimit	
Spitale, salla, dhoma (Brenda)	Prishja e gjumit naten, dite dhe ne mbremje	30	8	40
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim ne pushim, clodhje	#1		
Zona me aktivitet social ekonomik				
Zona industrial, tregetare, qarkullimi Trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Dëmtim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, industri dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/	100	4	110

	vit)			
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85# 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

Laeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

Lamax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (Lamax, fast) matur 100 mm larg veshit.

3= Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

Ndikimet negative nga zhurmat dhe vibrimet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ato janë vlerësuar të jenë te pranueshme me amplitude te vogël dhe mund të zbuten me marrjen e masave të përshtatshme të propozuara.

Masa teknike për mbrojtjen në punë

- Për vetë natyrën e projektit, respektimi i kriterëve teknikë të operacioneve gjatë të gjithë veprimtarisë së zbatimit të projektit është i një rëndësie të veçantë.

- Zbatimi i shesheve të distancave të sigurore prej elementeve të infrastrukturës ku punohet etj, mbrojtja rigoroze gjatë gjithë periudhës së zbatimit e garantimi i sigurisë në objektet sipas projektit për periudhën që funksionon.

- Respektimi i plotë i Regullores së Sigurimit Teknik që lidhet dhe me mënyrën e zgjidhjeve teknike të zbatimit të tyre të të gjitha operacioneve të punës.

Në vijim paraqitet një listë kontrolli për Masat Zbutëse të këtij projekti:

Tabela Nr. 6

Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
-----------------------	--------------------	---------------

1	Mjedisi Fizik Dherat	- Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	-Mbrotjtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për banoret ose bizneset perreth, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara -Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të vendosjes së elementeve metalike për strukturen mbajtëse -Projektimi i drenazheve dhe mjeteve të tjera të hedhjes së mbeturinave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor
	Toka	-Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	Mbrotjtja e zonave jo-ndërtimore -Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës -Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve -Transportimi/hedhja e materialeve në vende të aprovuara
	Cilësia e Ajrit	-Pluhuri dhe tymrat gjatë ndërtimit	-Të kontrollohet pluhuri me ujë, të kontrollohen metodat e ndërtimit, afatet e punimeve, shpejtësia e automjeteve -Projektim i përshtatshëm, training në masat e sigurisë, të operimit dhe mirëmbajtjes
	Mjedisi Akustik	-Zhurma nga punimet ndërtimore,	-Të përcaktohen afatet e punimeve për të minimizuar shqetësimet -Të përdoren metoda dhe paisje për mbrotjtjen nga zhurmat
	Mjedisi biologjik		
	Habitatet Natyrore	-Shqetësimi i habitateve natyrore nga ndërtimi p.sh. pluhuri, zhurma, hedhje e mbeturinave të patrajtuara, etj.	- ne zonen ku do të kryhen punimet për mbrotjtjen lumore nuk ka habitate natyrore e si rrjedhojë nuk merren as masa në këtë aspekt
	Fauna dhe Flora	-Humbja ose degradimi mbas ndërtimeve, ndryshimet në regjimet mjedisore, etj	-Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore -Mbrotjtja e zonave të ndjeshme mjedisore brenda/afër vendit të projektit
	Mjedisi Social		

Estetika dhe Terreni	-Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje bimësie, etj. -Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	-Mbiellje e pemëve dhe gjelberim i zonave ndërmjet kufijve, etj. dhe rigjëlberim i zonave të punimeve. -Kryerje me kujdes e mbylljes së pikave të punimeve dhe hedhjes së mbeturinave -Sistemimi i territorit sipas projektit të zbatimit.
Shëndeti i Njerëzve	-Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore -Efekte mbi shëndetin dhe sëmundje nga mbeturinat, ujrat e ndotur, rreziqet nga zjarri etj.	-Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë, të përfshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentat e kontratës. -Të sigurohet informacion mbi masat zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nëvojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, -Projektim i sakte dhe trainim i përshtatshëm për masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë, etj. -Hedhje e kujdesshme e mbeturinave

Plani monitorimit të mjedisit

Qellimi i monitorimit mjedisor për veprimtarinë e projektit është që të sigurojë të dhëna nepermjet të cilave të vlerësohet nëse operimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore që lidhen me të, si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuader të përmirësimit të vazhdueshëm. Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues të gjithë aktivitetet të cilët veprojnë në mjedis monitorohen përse i përket ndikimit që ato kanë në mjedis. Ky monitorim bëhet në mënyrë që të nxjerrim konkluzione sa më të sakta për të kryer ndërhyrjet e nevojshme.

Monitorimi do të përqendrohet kryesisht në:

- Faktoret që gjenerojnë ndikime negative në mjedis
- Efektet e këtyre ndikimeve
- Zbatimin e masave për zbutjen e tyre

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete investitoret ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit. Interpretimi i nje gjendje te caktuar mjedisore duhet bere ne lidhje te ngushte me fazen ne te cilen gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se nje gjendje e perkeqesuar e mjedisit ne nje faze te caktuar te zbatimit e cila eshte faze tranzitore nuk eshte tregues absolut i realizimit te objektivave te projektit.

Monitorimi per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe. Reduktimin e ndikimit mjedisor kompania synon ta arrijë duke:

- Zbatuar standarte ndërkombëtare;
- Zbatuar teknologji bashkohore;
- Zevendesuar paisjet dhe mjetet e amortizuara;
- Rehabilituar tokën brenda fushës së ndertimit;
- Riparuar dhe ndërtuar rrugë të reja;
- Pastruar kanalet e kullimit

Me VKM per programin e monitorimit ne RSH jepen qarte indikatoret mjedisor qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershtaten dhe ti perkasin veprimtarise.

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem. Programi i Monitorimt, per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe.

Elementet qe do te monitorohen do te dorezohen ne institucionet pergjegjegjese sa here qe do kerkohen, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve ne fuqi.

2.9 Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar.

Projekti nuk ndikon cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit as te shteteve fqinje, as te qendrave te banuara te rajonit.

Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

Ekspert Mjedis

Ing. Shpetim CIKU (Hydro-Eng Consulting (HEC) Sh.p.k)